

Ingo Schulze

Adami dhe Evelina

për Claran dhe Franziskan

Ingo Schulze

Adami dhe Evelina


roman

përktheu nga origjinali Ardian Klosi



© BV Berlin Verlag GmbH, Berlin
© për përkthimin shqip Ardian Klosi
k & b, Tiranë 2009

Ky libër u botua me ndihmën e TRADUKI-it, një rrjet që mbështet letërsinë, iniciativë e përbashkët e Ministrisë Austriake për Çështjet Europiane dhe Ndërkombëtare, Ministrisë së Jashtme Gjermane, Këshillit Zviceran të Arteve Pro Helvetia, KulturKontakt Austria, Insitutitit Goethe dhe Fondacionit S. Fischer

traduki 

kopertina: Jutta Benzenberg
shtypur në shtypshkronjën Natyra, Tiranë

ISBN 978-99956-805-2-7

PËRMBAJTJA

1	Dhoma e errët.....	9
2	Lili.....	15
3	Adam, ku je?.....	20
4	Largimi.....	24
5	Përse gënjen prapë Adami?.....	29
6	Të nesërmen në mëngjes.....	35
7	Nisja.....	37
8	Rrugë të tërthorta.....	42
9	Kufiri i parë.....	47
10	Njëri ia del mbanë.....	51
11	Dyshimi.....	57
12	Një grua tjetër.....	62
13	Traktativa.....	65
14	Kuturisja.....	70
15	Duarzbrazur.....	78
16	Jetë heronjsh.....	80
17	Përgatitje për ndarje.....	84
18	Ndarje e dështuar.....	89
19	Kamping i sajuar.....	94
20	Ritakim i parë.....	98
21	Njëlloj ftese.....	103
22	Një orvatje e re.....	108
23	Kronikë e ditës së parë.....	111
24	Thesari.....	116
25	Shpërthimi i madh.....	121
26	Çifte.....	125
27	Adami punon.....	130
28	Lojëra me hije.....	135
29	Gra.....	140
30	Mbrëmjes nën dritën blu.....	146
31	Një udhëtim i përbashkët.....	154
32	Punë për përjetësinë.....	156
33	Zgjedhjen e kanë damat.....	162
34	Një përrallë.....	167

35	Tërhequr me litar.....	171
36	Një e diel.....	175
37	Zjarr i gëzueshëm.....	180
38	Edhe një udhëtim me makinë.....	185
39	Keqkuptimi.....	189
40	Lexim në shtrat.....	194
41	Ndarja.....	200
42	Njohje.....	204
43	Dy kërkesa.....	212
44	Në kabinën telefonike.....	218
45	Spiunë.....	222
46	Spiunë, për herë të dytë.....	230
47	Bisedë në kuzhinë.....	236
48	Pas telefonatës.....	240
49	Dy gra.....	245
50	Xhevahirë.....	252
51	Liçeni i Zyrihut dhe drita e gjelbër.....	257
52	Vëlla dhe motër.....	262
53	Kthim fatkeq.....	266
54	Gjërat e fundit.....	273
55	Zjarr.....	279

Thellë në brendësi të vetes jemi të bindur se do të jetojmë përjetësisht. Përkohshmërinë dhe vdekshmërinë tonë i shohim si gjëra që na janë diktuar me përdhunë. Autentike është vetëm parajsja, bota nuk është e tillë - dhe ajo ekziston vetëm përkohësisht. Ndaj dhe rrëfimi flet për mëkatin e ndjenjave tona, sikur të na thërriste sërish në kujtesën e dremitur një uri të vjetër.

Nga "Abetarja ime" e Ceslav Milosshit

Etërit e kishës, jo vetëm Augustini, e shpallën herezi të thoshe se Adami e bashkë me të Eva ishin dënuar njëherë e përgjithmonë. E pra u bënë shenjtorë; dita e nderimit të tyre u caktua 24 dhjetori. Së fundi arritën të bëhen patronë mbrojtës, por jo siç mund të pritej, të frutikulturës, por të esnafit të rrobaqepësve. Ishin tek e fundit njerëzit e parë që veshën rroba. Dhe rrobat e tyre i kishte qepur vetë Perëndia.

Nga "Eva dhe Adami" i Kurt Flasch

DHOMA E ERRËT

Ja ku u shfaqën më në fund ato, gratë. Ia behën nga hiçi, të stisura me rrobat e tij, pantallona, funde, bluza e pallto. Nganjëherë atij i dukej sikur ato jepeshin nga bardhësia apo sikur qenë shfaqur krejt papritur, si ta kishin çarë syprinën për të treguar vetveten. Atij i duhej vetëm të epte pakëz mënjane enën e cektë me solucionin zhvillues, më shumë jo. Më së pari nuk dukej asgjë e pastaj befas shfaqeshin ato. Veçse çasti midis Hiçit dhe Diçkasë nuk kapej dot, thua se nuk ekzistonte.

Tabaku i madh rrëshqiti në enë. Adami e përmbysi atë me pincat plastike, e zhyti më thellë, e rrotulloi edhe një herë, ia nguli sytë së bardhës, duke soditur më pas mendueshëm figurën e një gruaje me fustan të gjatë që i linte zbuluar një sup e pastaj i shkonte përçark si spirale trupit të kolmë, gati-gati si të kish ndodhur një mrekulli, si ta kishte shtyrë ndonjë shpirt të nxirrte në shesh figurën e vet.

Adami e mbajti për një hop fotografinë ngritur lart me pincat. Sipërfaqja e zezë e sfondit tani ishte çelur, por pa ia prisur konturet fustanit dhe sjetullës. Mori nga cepi i tavllës puron, e thithi dhe e shfryu pastaj tymin mbi fotografinë e njomë, përpara se ta zhyste atë në enën me kronometër e prej aty në enën tjetër me solucionin fiksues.

E trazoi gërvima e portës së oborrit. Ndje hapat që po dëgjoreshin gjithmonë e më shumë, tri shkallë përpjetë, deri edhe goditjen e mbytur të trastës së pazareve kur kjo goditi pas derës së shtëpisë tek hapej.

“Adam, aty je?”

“Po!”, briti ai fort që ajo ta dëgjonte.

“Këtu!” Takat e saj ecën përmbi kokën e tij, ndërkohë që ai i frynte lehtë negativit, e pastronte atë me një lëkurëz e pastaj e vendoste përsëri në aparatën stampues. Mprehu kontrastin e figurës pastaj fiku dritën e aparatit. Dëgjoji të hapej e të mbyllej sërish në kuzhinë rubineti, pastaj hapat u kthyen mbrapsht, befas ajo kërceu mbi një këmbë teksa hiqte sandalet. Kërcitën shishet e zbrazëta në shportën që ndodhej prapa derës së bodrumit.

“Adam?”

“Hm.”

Ai nxori një tabak nga pakoja 18x24 cm, duke e rregulluar atë në kuadrin e stampimit.

Evelina zbriti shkallë pas shkalle përposhtë. Tani duhet t'i jenë bërë gishtërinjtë me pluhur, sepse prek me to tavanin e ulët në mënyrë që të mos përplasat gjëkund.

E mori përsëri puron dhe e thithi disa herë radhë, derisa u gjend krejt i mbështjellë në tym.

E gradoi kronometrin në 15 sekonda e pastaj shtypi butonin e madh drejtkëndor – drita u ndez sërish dhe kronometri nisi të gumëzhinte.

Sikur të trazonte diçka, Adami zuri të lëvizte mbi kokën e gruas një lugë alumini të dystuar, e hoqi pastaj me shpejtësi, zgjati gishtërinjtë e vet duke i llokoçitur pak në ujë e duke i bërë me to hije trupit të gruas. I tërhoqi ata pastaj menjëherë, para se të fikej drita e aparatit e të rreshtte gumëzhima.

“Puh, ç'kutërbim! Po pse duhet të tymosësh këtu kaq shumë Adam?!”

Adami e zhyti letrën me pinca në solucionin zhvillues. Nuk i pëlqente kur e shqetësonin gjatë punës me fotot. As radion nuk e duronte dot këtu brenda.

Evelina, e cila edhe zbathur ishte ndonjë gjysmë koke më e gjatë se Adami, erdhi me të prekur tek ai pastaj e çiku në sup. “Mendova se do na bëje ndonjë gjë për të ngrenë.”

“Me këtë vapë? U mora gjithë kohën me korrrjen e barit.”

“Duhet të iki.”

Mbi letrën e bardhë u shfaq përsëri gruaja me fustanin e gjatë. Adami nervozohet shumë që ajo e tërhiqte barkun nga brenda, i dukej madje se shihte buzëqeshjen e saj teksa mbante frymën. Por ndoshta edhe gabohej. E zhyti me pinca fotografinë në banjën e kronometruar e pastaj prej aty në solucionin fiksuës. Pastaj nxori një tabak të ri nga pakoja, e palosi atë në mes dhe e grisi më dysh te zgripi i tryezës. Gjysmën tjetër e futi sërish në pako.

“Çfarë po ha?”, pyeti ai.

“Mbylli sytë. Mos u çakërrit ashtu.”

“Janë të larë?”

“Po, mos ki frikë se të helmoj”, tha Evelina dhe i futi atij në gojë një kokërr rrushi.

“Ku kishte nga këto?”

“Tek Kreçmanët. Plaku më dha një qese më shumë, as nuk e dija se ç’kishte brenda.”

U ndez drita e stampimit.

“E çfarë t’i them tani Gabrielës?”

“Mbaje varur.”

“Po duhet t’i them sot patjetër diçka. Derisa ma japin lejen në gusht, duhet ta pranoj.”

“Ajo nuk është në vete. Ne do të ikim kur të duam.”

Drita u shua.

“Po ne donim të iknim në gusht. Ti vetë the në gusht, edhe Pepi tha se në gusht është më mirë. Pa fëmijë nuk të japin kurrë leje në gusht. Veç kësaj skadon edhe viza.”

“Ajo nuk është vizë.”

“S’ka rëndësi se si quhet. Ne e kërkuam lejen për në gusht.”

“Ajo vlen deri në 10 shtator.”

Adami e tërhoqi letrën përmes enës pastaj e rrotulloi dy herë.

“Hëm, ç’e mirë”, tha Evelina kur u shfaq aty gruaja në kostum me pantallona, e cila i kishte lidhur duart pas shpine dhe nxirrte përpara gjinjtë.

“Kishte ardhur postë?”, pyeti Adami.

“Asgjë”, tha Evelina.

“Pse nuk udhëtojmë me tren?”

“Nuk dua të ngulem gjithë kohës në një vend. Pa makinë është shumë e mërzitshme. Ke edhe më?”

Evelina i futi në gojë kokrrat e mbetura të rrushit pastaj i fshiu duart e lagëta pas xhinseve.

“Çfarë t’i them tani Gabrielës?”

“Të na japë të paktën një javë afat.”

“Atëhere zëre se ka mbaruar gushti.”

“Mund ta ndezësh dritën”, tha ai si e kishte futur foton në solucionin fiksues. Shkoi te lavamani katror ku pluskonin një numër fotografish, peshkoi njëren syresh dhe e vari atë te filli bashkë me të tjerat.

“Kush është kjo?”

“Lili.”

“Po emri i vërtetë?”

“Renate Horn nga Markleeberg.”

“Ke edhe më?”

“Duhet të ngjitesh lart. Po kjo këtu?”

“Po ti e njeh, Desdemona.”

“Kush?”

“Ajo, Albrehti, nga poliklinika, gjinekologia.”

“Ajo që ka atë algjerianin?”

“Nuk ka ajo ndonjë algjerian. Po ju keni shtrënguar njëherë duart bashkë. Këtë” - Adami dëftu një fotografi të varur në fill – ia kam bërë në qershor.”

“Ej ti...” Evelina i erdhi fotografisë fare pranë. “Po kjo ka veshur këpucët e mia, po po janë këpucët e mia!”

“Si?”

“Po këto janë të miat, ja shihi majat, edhe gërvishtjen, ej tim je në vete?!”

“Ato s’ua kanë idenë këpucëve, më vijnë këtu me ca opinga që i prishin të gjitha, për dhjetë sekonda i kanë huajtur...”

“Po unë nuk dua që këto femrat e tua të veshin këpucët e mia. Nuk dua as që ti t’i fotografosh në kopsht e aq më pak në dhomën e ndenjes!”

“Ishte shumë nxehtë lart.”

“Nuk e lejoj!” Tani Evelina filloi t’i vështronte me vëmendje edhe fotografitë e tjera.

“Do të nisemi pasnesër?”

“Sapo të na vijë karroja, nisemi.”

“Këto i dëgjoj tash tri javë.”

“I mora në telefon, ç’mund të bëj tjetër unë?”

“As që kemi për t’u nisur fare. Vëmë bast po të duash.”

“Ke për të humbur.”

Adami nisi të nxjerrë prej ujit fotografi mbas fotografie.

“Ke për të humbur, dorë me një.”

“Nuk do të marrim vizë asnjëherë tjetër. Edhe tani s’do të na jepnin më. Ekanë bërë rregullin që duhet të jesh të paktën pesëdhjetë vjeç, thotë Gabriela.”

“Eee Gabriela. Ajo të përrallis sa të duash.”

“Kjo këtu është e bukur. Çfarë ngjyre është, e kuqe?”

“Blu, mëndafsh.”

“Përse nuk bën fotografi me ngjyra?”

“E solli vetë mëndafshin, kurse kjo këtu...” Adami po mbante ngritur një fotografi ku shihej një grua e re me fund të shkurtër e një bluzë që i rrinte gjerë.

“Me çmim të kripur, edhe në Perëndim, por nuk e ndjen fare në lëkurë, aq fine është.”

Adami palosi një fotografi të njomë dhe e hodhi në koshin e letrave.

“Çfarë bën ashtu?”

“Nuk bënte.”

“E pse jo?”

“Shumë e errët.”

Evelina futi dorën në koshin e letrave.

“Sfondi është plot me vrima të zeza”, tha Adami.

“Lili është kjo?”

“E saktë!”

Evelina e hodhi fotografinë aty ku e kishte marrë, pastaj shkoi në parashkrim të raftit me frutat e konservuara.

“Edhe këto nuk po hahen fare. Do dardha apo mollë?”

“Po ftonj ka më? Mbyllle derën!”

Adami fiku dritën dhe priti derisa të binte dera në bravë.

“Nga viti '85, në qoftë se e lexoj mirë që kjo është pesë”, thirri nga jashtë Evelina.

“S'ka rëndësi.” Ai nxori nga pakoja gjysmën e tabakut, e vuiri atë nën aparat, zgjodhi një negativ të ri, rregulloi kthjelltësinë pastaj shtypi butonin e kronometrit. Adami zuri të gumëzhinte në të njëjtin tonalitet.

“Do të të hedh edhe ty në një tas?”

“Më vonë.”

“Do shkosh sot në muzeum?”

“I kanë filluar guidat përsëri?”

“Po, dhe unë prapë mbeta pa gjë.”

“As unë nuk mundem dot, do më vijmë për provë”, tha Adami.

Për një çast ra heshtje. Ai e la letrën të rrëshqiste në solucion, e shtypi pakëz për poshtë. Në parashkrim kërciti çelësi i dritës.

“Evi?”

Ai dëgjoi përsëri trokëllimën e shisheve bosh.

“Evi!”, thirri ai e desh të shkonte pas saj, por pas një hopi u përkul thellë mbi enë si të donte të sigurohej se gruaja që sapo u shfaq aty duke qeshur e me krahët hapur, po vështronte me të vërtetë atë.

2 LILI

Disa orë më vonë në atë 19 gusht 1989, një të diel, Adami ishte përkulur në gjunjë te këmbët e një gruaje në mes të dyzetave, në gojë mbante ndonjë gjysmë duzine gjilpëra me koka, rrotull qafës metrin. Ajo kishte hequr bluzën e po bënte fresk me revistën "Magazine". Vapa kishte bërë fole në atë papafingo të përshtatur, sadoqë ishin çelur dritaret e pullazeve trekëndëshe dhe baxha e çatisë. Makina qepëse ishte mbuluar tanimë, tryeza ku ai priste copat ishte pastruar; gërshërët qenë sërënditur sipas madhësisë, përbri tyre rrotullat e lëmshat e penjve, trekëndësja, vizore, shablona, shkumësat e rrobaqepësit, paqeta e cigareve me tehet e brisqeve dhe kutiza për kopsat pas së cilës rrinte mbështetur një fotografi. Deri dhe tabakaja me dy gota gjysmë të zbrazura me çaj dhe kutinë e sheqerit qe vendosur paralel me buzën e tryezës. Nën tryezë rrinin stivë rrotullat e stofrave. Nga bokset e gramafonit vinte një muzikë e përshkuar tej e tej nga gërvishtje.

"Vivaldi është ky?", pyeti Lili.

"Hajdni", nxori me zor zërin Adami nga buzët e shtrënguarra, "mos e fut brenda barkun!"

"Çfarë?"

"Mos e fut brenda barkun!" Adami e shtrëngoi rishmë llashtikun e fundit.

"Nuk e kuptoj pse nuk merr Danielën. Ajo është e bukur, është e re dhe paguan sa t'i kërkosh. Nuk dëshiron as t'i qepësh rroba të modës së fundit. Veç kësaj i ati ka një oficinë, në të vërtetë për Skoda, megjithatë po të kesh hall të ndihmojnë. Pastaj nuk ka as ngut. Daniela pret edhe në fund të radhës."

E hodhi «Magazinen» mbi tryezë.

“Kur do të ikni? Të erdhi Lada e re?”

Adam tundi kryet. Lili vështroi në pasqyrë pjesën e sipërme të krahut të mëngjër që ishte ngritur në gjysmë lartësie dhe rregulloi pak krehjen e flokëve. Gishti i Adamit u end mbi llas-tikun e fundit të saj.

“Mos hungëro ashtu”, tha ajo. “Nuk do ta fus brenda bar-kun, mos kujto se jam fillestare!”

Vështrimet e tyre u ndeshën në pasqyrë.

“Pak më të shkurtër, them”, tha Lili.

Adami palosi fundin nga brenda, vështroi në pasqyrë pastaj tundi kokën.

“Jo? Po kështu s’duken këmbët fare”, tha Lili.

Adami caktoi gjatësinë, pastaj buzëqeshi, çka i dha një pamje tepër të brengosur.

“Ç’është?”, thirri ajo.

“Shiko, pse nuk i bën më të mëdha iliqet e brezit?”

Adami e mbërtheu Lilin nga vithet, e rrotulloi pastaj hoqi gjilpërat nga buzët.

“Këtu do të bëj një të çarë, kupton? Një të çarë. Duhet t’i ngulin sytë aty, t’u përdridhen qafat fare. Dhe shiko të gjesh ndonjë rrip të ngushtë, elegant. Njëzet centimetra do ta bëj, pak a shumë njëzetë prej këtu.” Ai nguli përsëri një gjilpërë e më në fund drejtoi shtatin. “Bukur, tani këpucët, rrotullohu nja dy herë.”

Lili mbathi këpucët e lehta ngjyrë kafe, rendi te dritarja ku bëri në majë të gishtërinjve një rrotullim të shpejtë e pastaj shkoi te trekëndëshi tjetër i pullazit dhe u rrotullua edhe aty.

Adami kishte marrë puron nga tavlla e bakërt dhe e thithi atë fort derisa maja iu prushit.

Lili ndaloi përpara tij, me duart mbështetur mbi vithe.

“S’më besohet që jam unë ajo aty. Te ty bëhem edhe fotog-jene!”

“Vazhdo, vazhdo”, tha ai.

Kur kaloi përsëri para tij, Lili i tundi dorën, kurse Adami hoqi puron nga goja dhe i lëshoi asaj tymin mbi zverk.

“Mjafton, eja tani këtu!”, thirri ai. “Prapë e fute barkun brenda.”

Adami donte t’ia shtypte me gisht mullëzën e vogël mbi llastikun e fundit, por Lili u shmang. Bëri sikur nuk e dëgjoji dhe shtroi flokët nga pas. Edhe ajo po djersinte.

Adami afroi pasyrën e dytë.

“Duhet të heq diçka këtu te e pala e fundit. Të tjerat janë për bukuri.”

Mollaqet e saj u tendosën nën duart e Adamit.

“Në të vërtetë më pëlqen që nuk e do Danielën. Se pastaj do të t’hyjë në qejf lozanjarja e njomë. Astari është i mrekullueshëm, ndihet shumë mirë mbi lëkurë. Ku e ke gjetur? Po të mos më merrej fryma, do të filloja të kërrisja. A nuk mund ta flakësh atë duq të qelbur! Do të shpifet kanceri i mushkërive.”

“Këtë difektin në endje do ta mbuloj, as ka për t’u parë fare”, tha ai dhe nguli nja dy gjilpëra pranë palës së fundit.

“Në shtëpi e nuhasin gjithmonë që kam qenë te ti. Sado që çdo herë laj flokët.”

Adami ia tërhoqi pakëz me kujdes fundin. “Rri mirë, tundet, ajriset siç duhet”, tha ai. “Rrotullohu pak!”

Kur ajo e vështroi në mënyrë pyetëse, ai përsëriti: “Rrotullohu! Dhe hiqi pak këto!”

Lili zbërtheu sutjenat, lëshoi rripkat poshtë e pastaj i mbajti ato mes pëlqyerit dhe gishtit tregues.

“I kënaqur je?”, pyeti ajo kur sutjenat ranë në dysheme.

Adami mori xhaketën e kostumit nga manekini i madh. Lili zgjati krahët nga pas, i rrëshqiti duart brenda në mëngë, e tërhoqi xhaketën mbi supë dhe u rrotullua. E vështronte atë në sy, ndërkohë që ai ia mbyllte xhaketën me gjilpëra.

“Gjeta ca kopsa të mira për këtë në dyqanin e antikave, gjëra të rralla, sedef i pastër, mallra të paralufte, do kishte thënë zotëria im plak.”

Adami bëri një hap praptas.

“Hë si thua? Zgjati pak krahët nga përpara, të dy, edhe anash... E bëra me bel. Mos e ke shumë të ngushtë?”

“E pse? Jo!”, tha Lili duke u parë në pasqyrën e dytë.

“Ose do gjesh një palë sutjena për të qënë, ose s’do veshësh gjë poshtë, shiko, më mirë mos vish asgjë poshtë.”

“Kopsën e mesit pak më lart, edhe këtu duhet të heqësh diçka edhe andej edhe këtej, e shikon, kështu vjen në formën e duhur.”

Ai u tërhoq për anash duke vështruar se si rrotullohej Lili para pasqyre, si i vendoste pëllëmbët mbi bel dhe fërkonte stofin.

“Ah, Adam”, tha Lili në çastin kur filloi dueti i fundit. “Në të vërtetë duhet të dhuroj çdo herë që vij nga një buqetë me trëndafila.”

Adami shfryu një re të vogël tymi në drejtim të baxhës së çatisë. Njëfarë kohe u dëgjua vetëm muzika, të dy dukeshin sikur po mbanin vesh këngën.

“Ti meriton një kopsht të tërë me trëndafila!”

Adami vendosi puron mbi parvazin e dritares, me majën përmbi zgrip.

“Të jesh e sigurtë”, tha ai, “të gjithë kanë se ç’të shohin, daç nga para, daç nga mbrapa, por edhe në profil.” Mori në dorë gotën gjysmë të mbushur me çaj, e trazoi edhe një herë, lëpiu lugën, pastaj e piu të tërin dhe iu afrua Lilit fare pranë. Për një çast vështroi kopjet e saj të panumërta në pasqyra. Pastaj i vendosi midis gjinjve bishtin e lugës që qëndroi aty pa lëvizur.

“E shikon, të thashë, nuk ke nevojë për asgjë tjetër.”

Luga mbeti e palëvizur edhe kur Lili u mbështet me shpinë pas tryeze dhe Adami që ia kishte ngritur fundin me kujdes përpjetë, hyri brenda saj.

“Jo kaq shpejt”, tha Lili, “dhe ki kujdes se po më pikon mbi kostum!”

Adami fshiu ballin me mëngën e vet dhe shtyu kutizën me sumbulla dhe fotografinë e saj pakëz më pas.

Në taktet e fundit të korit përmbyllës Lili kapi metrin që rrinte gjithë kohën varur në qafën e Adamit dhe e tërhoqi atë poshtë drejt vetes derisa sytë e tij u ndodhën gati ngjitur me të sajët.

“Adam”, pëshpëriti ajo. “Adam, nuk do të ikësh, apo jo?”

Mezi po mbushej me frymë.

“Ke për t’u kthyer, Adam, do rrish këtu apo jo?”

“Ç’janë këto marrëzira tani?”, tha Adami.

Pa djersët mbi buzën e sipërme të Lilit, i ndjeu frymën mbi fytyrë, nën dorën e tij të djathtë zemra e saj rrihte si e marrë.

“Më premt, Adam, më premt”, briti Lili befas kaq fort saqë ai vetiu ia mbylli gojën me dorë. Këtu luga rrëshqiti prej dekoltesë së saj. Adami ia mori prej supit dhe e ktheu prapë te gota e vet, ku u dëgjua tani një tringëllimë e butë, gati-gati e kthjellët si tingulli i kambanës.